

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN**  
**“PËR**  
**POLICINË BASHKIAKE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji “Për policinë bashkiake”, ka për qëllim të rregullojë misionin, organizimin, funksionimin, kompetencat e Policisë Bashkiake dhe marrëdhëniet e punës të punonjësit të policisë bashkiake në Republikën e Shqipërisë.

Ky projektligj vjen si domosdoshmëri dhe si një detyrim ligjor, i cili buron nga Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, e cila është miratuar me vendimin nr. 691, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave, Raport “Matrica e Kompetencave të Vetëqeverisjes Vendore”, si dhe nga ligji organik nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjithashtu, nevoja e hartimit të këtij projektligji është parashikuar në politikën për rritjen e parametrave të sigurisë në komunitet, të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021–2026 dhe të planit të veprimit 2021–2023, miratuar me vendim nr. 1139, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave. Referuar masës 15 të strategjisë është parashikuar rishikimi i rolit dhe përgjegjësi të policisë bashkiake, si vijon: “Masat kyçe do të lidhen me rishikimin e ligjit për Policinë Bashkiake, i cili do të mundësojë kërkesa dhe standarde më të larta për këto struktura në funksion të sigurisë publike, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator dhe fuqizimin e bashkëpunimit të strukturave të Policisë Bashkiake me strukturat e Policisë së Shtetit”.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji është planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2021.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Policia Bashkiake është strukturë në varësi të bashkisë, e cila angazhohet në zbatimin e detyrave që i ngarkon ligji organik për vetëqeverisjen vendore,

vendimet e këshillit bashkiak, si dhe akte të tjera të nxjerra nga kryetari i bashkisë. Referuar parashikimeve të këtij ligji, Policia Bashkiake është organ ekzekutiv që ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, në mbarëvajtjen e punëve publike, mirëadministrimit të hapësirave publike në territorin e juridiksionit të saj, zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve të nxjerra nga organi përfaqësues dhe ekzekutiv i bashkisë.

Duke marrë në konsideratë rolin e saj në ndihmë të ushtrimit të funksioneve të organeve dhe strukturave të bashkisë, situatën problematike të krijuar ndër vite në lidhje me zbatimin në praktikë të këtij ligji, pasi tashmë puna e policisë bashkiake ka marrë një dimension edhe më të gjerë, e bën të domosdoshme hartimin e këtij projektligji në funksion të mbarëvajtjes normale të punës dhe efektivitetit të detyrave të ushtruara nga kjo strukturë.

Projektligji, në tërësinë e tij, parashikon të japë zgjidhje përfundimtare situatës së krijuar ndër vite me këtë strukturë, duke adresuar të gjitha shqetësimet dhe ofrimin e zgjidhjeve nëpërmjet mënyrës së rindërtimit të kësaj strukture, organizimit, funksionimit dhe pranimi në policinë bashkiake. Gjithashtu, është ridimensionuar bashkëpunimi, me strukturat e Policisë së Shtetit duke qartësuar kompetencat me këtë të fundit dhe institucione të tjera ligjzbatuese.

Projektligji mundëson kërkesa dhe standarde më të larta për këto struktura në funksion të sigurisë publike, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator dhe fuqizimin e bashkëpunimit të strukturave të Policisë Bashkiake me strukturat e Policisë së Shtetit. Një ndër risitë e këtij projektligji është edhe hartimi i një Rregullore Kuadër në bashkëpunim të ngushtë edhe me aktorët vendorë, që do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, projektligji parashikon që në varësi të numrit të banorëve, duke e përllogaritur në referim të popullsisë faktike dhe sipas specifikimeve që i nevojiten çdo bashkie, organizohet si rregull në drejtori dhe sektorë, të detajuara në rregulloren kuadër. Përcaktimi i numrit të policëve do të përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës, duke e përllogaritur në referim të popullsisë faktike dhe sipas specifikimeve që i nevojiten çdo bashkie, për arsye të përcaktimit të standardeve, i cili i jep mundësinë Kryetarit të Bashkisë të krijojë një Polici Bashkiake eficiente përsa i përket administratës apo numrit të Policisë Bashkiake.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi, konkretisht me kuadrin ligjor që rregullon çështjet vendore.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT**

Projektligji përbëhet nga 10 krerë, konkretisht si vijon:

**KREU I, DISPOZITA TË PËRGJITHSHME:** Në projektligj përcaktohet se policia bashkiake, krijohet me qëllim të ushtrimit të funksioneve në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, në mbarëvajtjen e punëve publike, mirëadministrimit të hapësirave publike në territorin e juridiksionit të saj, zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve të nxjerra nga organi përfaqësues dhe ekzekutiv i bashkisë. Gjithashtu, në këtë kre janë përcaktuar parimet në bazë të të cilave udhëhiqet Policia e Bashkisë në veprimtarinë e saj.

**KREU II, STATUSI, JURIDIKSIONI, SIMBOLET DHE UNIFORMA:** Projektligji përcakton në mënyrë të unifikuar simbolet, juridiksionin brenda territorit administrativ të bashkisë, si dhe statusin e policisë bashkiake si një strukturë e depolitizuar.

**KREU III, ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE KOMPETENCAT:** Dispozitat e këtij kreu rregullojnë organizimin dhe përbërjen e strukturës së Policisë Bashkiake në klasifikimin e punonjësve, rolin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore në përcaktimin e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake, si dhe përcakton detyrat e kompetencat e Kryetarit të Bashkisë. Gjithashtu, në këtë kre janë parashikuar këto detyra e kompetenca kryesore të Policisë Bashkiake:

- a) siguron zbatimin e akteve të nxjerra nga kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak;
- b) siguron zbatimin e urdhrave të nxjerra nga kryetari i bashkisë, që kanë të bëjnë me personat juridikë e fizikë, të cilët nuk plotësojnë detyrimet ligjore, fiskale, apo çdo detyrim tjetër pasuror;
- c) parandalon, konstaton dhe shqyrton kundërvajtjet administrative në zbatim të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore brenda territorit të juridiksionit të saj dhe në përputhje me përcaktimet ligjore;
- ç) njofton dhe mbështet në rast marrje njoftimi apo konstatimi të punimeve ndërtimore pa leje, strukturën përgjegjëse për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore;
- d) merr masa për ruajtjen e objekteve në pronësi të bashkisë si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj;
- dh) merr masa për të siguruar lirin e hapësirave publike;

- e) merr masa për zbatimin e akteve të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore që përcaktojnë oraret e shërbimit të njësive tregtare, bar-kafeve, restoranteve, dhe të gjithë subjekteve të tjera me veprimtari publike;
- ë) merr masa për ruajtjen e afisheve, njoftimeve e shpalljeve publike si dhe heqjen e atyre të paligjshme ose të paautorizuara;
- f) merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me Komisionin e Mbrojtjes Civile pranë bashkisë dhe Prefektit të Qarkut për kapërcimin e tyre;
- g) kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor në territorin e juridiksionit të saj, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, si dhe sipas parashikimeve të marrëveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me Policinë e Shtetit;
- gj) bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikëqyrjen e sigurisë, brenda territorit të juridiksionit të saj;
- h) bashkërendon masat me Policinë e Shtetit, për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në raste të aktiviteteve, në territorin e juridiksionit të bashkisë;
- i) njofton strukturat përkatëse, kur konstaton ndotje akustike, për matjen e nivelit të zhurmave dhe për vazhdimin e procedurave të tjera ligjore;
- j) merr masat e duhura duke bashkëpunuar me strukturat përkatëse të bashkisë dhe ato jashtë saj për të garantuar mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet;
- k) konstaton kundërvajtje dhe zbaton sanksione për mosrespektim të normave mbi bashkëjetesën shoqërore të përcaktuara në aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, për faktet e konstatuara brenda territorit të juridiksionit të saj.

**KREU IV, STRUKTURAT DREJTUESE TË POLICISË BASHKIAKE:** Në këtë kre përcaktohen strukturat drejtuese të Policisë Bashkiake, konkretisht Drejtuesi i Policisë Bashkiake, si autoriteti më i lartë ekzekutiv dhe organizativ i Policisë Bashkiake, i cili përgjigjet drejtpërdrejtë përpara Kryetarit të Bashkisë për realizimin e politikave, performancës dhe objektivave të përcaktuara.

**KREU V, PRANIMI, FORMIMI DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIEVE TË PUNËS:** Projektligji parashikon që marrëdhëniet e punës së drejtuesit dhe të punonjësve të tjerë të policisë bashkiake rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Pranimi në policinë bashkiake bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale dhe mosdiskriminimit. Pranimi kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhjeje dhe testimi transparent e të drejtë sipas procedurës dhe kriterëve të përcaktuara për kualifikim. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e kriterëve etike dhe aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet konkurrimit, që përfshin një vlerësim paraprak të kriterëve të kandidatit, testim fizik, testim me shkrim dhe intervistë me gojë, sipas përcaktimeve në rregulloren kuadër. Gjithashtu, punonjësi i Policisë Bashkiake, gjatë periudhës të provës, përfundon trajnimin e detyrueshëm pranë Akademisë së Sigurisë. Bashkitë bashkëpunojnë me Akademinë e Sigurisë sipas përcaktimeve në rregulloren kuadër për organizimin e trajnimit të detyrueshëm. Mos përfundimi me sukses i trajnimit të detyrueshëm përbën shkak për

përfundimin e marrëdhënies së punës. Nisur edhe nga kërkesa e vazhdueshme e bashkive për trajnim të Policisë Bashkiake, projektligji parashikon që trajnimet e punonjësve të policisë bashkiake me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale bëhen në mënyrë periodike në Akademinë e Sigurisë, në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ose në institucione të tjera publike, këto të fundit mund të jenë institucione arsimore ose institucione të administratës publike, për trajnime lidhur me tema specifike si psh. financat, ekonominë etj.

**KREU VI, DETYRIMET DHE KUFIZIMET KRYESORE TË PUNONJËSIT TË POLICISË BASHKIAKE:** Në këtë kre janë përcaktuar detyrimet dhe kufizimet kryesore të punonjësit të Policisë Bashkiake, në respektim të ligjit dhe formimit profesional, detyrimin për zbatimin e urdhrave të ligjshëm që jepen nga një punonjës më i lartë në funksion, detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, detyrimin e mirëadministrimit të pronës, pajisjeve që i vihen në përdorim në ushtrimin e detyrës dhe shfrytëzimit me efektshmëri të kohës së punës.

**KREU VII, DISIPLINA:** Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë disiplinën e punonjësit të Policisë Bashkiake, pra, rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave. Gjithashtu përcaktohet se, çfarë përbën shkelje disiplinore duke i kategorizuar ato në shkelje të lehta dhe të rënda, si dhe parashikuar masat disiplinore për secilën prej tyre dhe detajimet e mëtejshme përcaktohen në rregulloren kuadër.

**KREU VIII, PAJISJET DHE AUTOMJETET:** Në këtë kre është përcaktuar se punonjësi i policisë bashkiake nuk mban armë për shkak të detyrës si dhe këtij të fundit i jepen në përdorim mjete dhe pajisje të tjera të përcaktuara në Rregulloren Kuadër të Policisë Bashkiake. Në ushtrimin e detyrës, përdoren edhe automjete lëvizëse, ngjyra, shenja, përdorimi i të cilave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**KREU IX MASAT PËR RUAJTJEN E RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE NË KOMUNITET:** Projektligji përcakton format, masat dhe mënyrën e pagesës së masës për shkeljet administrative të shkelësve të ligjit, përcakton të drejtën e Policisë Bashkiake në realizimin e detyrave për bllokimin e rrugëve, sekuestrimin dhe konfiskimin e sendeve, kontrollin e identitetit në rastet e parashikuara në këtë ligj. Projektligji parashikon bashkërendim dhe bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit dhe struktura të tjera ligjzbatuese në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, edhe në shërbim të realizimit të objektivit të programit të “Policimit në Komunitet”, për sigurinë dhe mbrojtjen civile.

**NË KREUN X PËRCAKTOHEN DISPOZITAT E FUNDIT,** konkretisht hyrjen në fuqi të këtij ligji 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, si dhe shfuqizimin e ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, të

ndryshuar, si dhe të dispozitave të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e policisë bashkiake dhe që bien ndesh me këtë ligj.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ministria përgjegjëse për çështjet vendore.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji është hartuar me kontribut kryesor të grupit të punës të ngritur me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. 302, datë 13.09.2021, për hartimin e projektligjit ‘Për Policinë Bashkiake’ dhe janë zhvilluar vazhdimisht takime të grupit të punës për hartimin e draftit të aktit. Gjithashtu, me urdhrin nr. 680 datë 27.12.2018 të Ministrit të Brendshëm ka qenë ngritur një grup i mëparshëm pune për hartimin e këtij projektligji. Më pas puna ka vijuar me marrjen e mendimeve të Bashkisë Tiranë, Pameca V, Shoqatës për Autonominë Vendore dhe të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, komentet e të cilave janë pranuar gjerësisht.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i këtij projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

**PROPOZUESI**

**MINISTRI**

**bledar çuçi**